

VENDIM
Nr. 126, datë 7.3.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 475, DATË 8.6.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E NJË TOGE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK
TË NATO-S NË LETONI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 475, datë 8.6.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:
 - a) Në pikën 1, numri “...18 (tetëmbëdhjetë)...” ndryshohet dhe bëhet “...21 (njëzet e një)...”.
 - b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor 2019, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit, për çdo togë, të jetë 6 (gjashtë) muaj, së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me togën e radhës.”.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama